



Kingdom of the Netherlands

# **SFIDAT E SHQIPËRISË NË ADRESIMIN EFEKTIV TË KRIMIT TË ORGANIZUAR: ZHVILLIMI I NJË KUADRI STRATEGJIK EFEKTIV DHE TË PËRMIRËSUAR NË PËRPTHJE ME QASJEN E BASHKIMIT EVROPIAN**

---

Dokument Politikash





CSDG

Qendra  
për Studimin  
e Demokracisë  
dhe Qeverisjes

Ky dokument u përgatit nga Qendra për Studimin e Demokracisë edhe Qeverisjes në kuadër të projektit “Përmirësimi i Debatit të Politikave dhe Llogaridhënies në Përbushjen e Grupit të Parë të Kapitujve Negociues (Cluster 1), përmes Krijimit të Platformës së Negociatave BE-Shqipëri për Cluster 1 (C1-EU-NPA)”, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë.

Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk reflektojnë opinionet apo pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë.



Kingdom of the Netherlands

**Autorë:**

Mirsada HALLUNAJ

**Redaktimi dhe korigjimi:**

Gentiola MADHI

**Dizajni dhe faqosja:**

Ergys TEMALI

# Përmbajtja

---

Lista e Shkurtimeve.....	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
Hyrje.....	6
Metodologjia.....	7
<b>I. Krimi i organizuar: Relevanca dhe Trendet.....</b>	<b>10</b>
Korrupsioni dhe ndikimi në sektorin publik.....	10
Përdorimi i Strukturave të Ligjshme të Biznesit .....	11
Përshtatshmëria dhe fleksibiliteti.....	12
Ekspertiza.....	12
Efektet e krimit të organizuar.....	13
<b>II. Shkalla e Përgatitjes së Shqipërisë për të adresuar Krimin e Organizuar.....</b>	<b>14</b>
Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë.....	14
Raporti për Trafikimin e Personave.....	16
Indeksi Global për Krimin e Organizuar 2021.....	17
Raporti Botëror i Drogave.....	19
<b>III. Qasja e Bashkimit Evropian në luftën kundër Krimin të Organizuar.....</b>	<b>21</b>
Qasja parandaluese.....	21
Hartimi i Strategjive përmes Analizave/Vlerësimeve .....	22
Analiza e kërcënimeve aktuale dhe atyre të ardhshme (SOCTA).....	23
Hartimi i Strategjive Gjithëpërfshirëse kundër Krimin të Organizuar.....	25
<b>IV. Qasja Strategjike e Shqipërisë në luftën kundër Krimin të Organizuar.....</b>	<b>27</b>
Strategjia kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025.....	28
Përputhshmëria me qasjen e Bashkimit Evropian.....	33
Konkluzione.....	36
Rekomandime.....	37
Referenca.....	39

## Lista e Shkurtimeve

---

BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
EMPACT	Platforma Shumëdisiplinore Evropiane Kundër Kërcënimeve Kriminale
EUCPN	Rrjeti Evropian për Parandalimin e Krimit
EUROPOL	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim të Zbatimit të Ligjit
FATF	Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar
GMIP	Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave
IGKO	Indeksi Global për Krimin e Organizuar
IPSIS	Sistemi Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar
KE	Komisioni Evropian
OFL	Operacioni "Forca e Ligjit"
PESTLE	Faktorët (Politikë, Ekonomikë, Sociologjikë, Teknologjikë, Ligjorë dhe Mjedisorë)
SIENA	Aplikacioni i Sigurt i Rrjetit të Shkëmbimit të Informacionit
SKOKR	Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda
SLB	Strukturat e Ligjshme të Biznesit
SNKKO	Strategjia Ndërsektoriale për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit
SOCTA	Vlerësim i Kërcënimit të Krimit të Rënda dhe të Organizuar të Bashkimit Evropian
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
VMT	Viktima të Mundshme të Trafikimit
VT	Viktima të Trafikimit

## Përmbledhje Ekzekutive

---

Krimi i organizuar përbën një nga sfidat e Shqipërisë gjatë dy dekadave të fundit, duke ndikuar në disa aspekte të shoqërisë. Zhvillimi, sofistikimi dhe trendet e krimit të organizuar kanë sjellë një shtim të vëllimit të veprimtarive kriminale, si edhe zhvillime të reja të strukturimit organizativ dhe mënyrës së tij të veprimit.

Duke qenë një vend kandidat për në BE në pritje të fillimit të negociatave të pranimit për t'u bërë anëtare e plotë, lufta kundër krimit të organizuar vazhdon do të mbetet një nga treguesit kryesorë për përparimin e Shqipërisë në këtë drejtim.

Megjithëkëtë, pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim, vlerësimet që lidhen me rezultatet e Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar janë ende të dobëta, dhe në tërësi lufta ndaj krimit të organizuar ka nevojë të forcohet më tej. Kjo theksohet edhe në Raportet e Komisionit Evropian gjatë 4 viteve të fundit (2018-2021), në të cilat niveli i përgatitjes së Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar ka mbetur i njëjtë (*njëfarë niveli përgatitjeje*).

Shqipëria filloi të miratojë një qasje strategjike për të luftuar krimin e organizuar 12 vjet më parë, në vitin 2000, ku nëpërmjet miratimit të një sërë strategjish synojesh të trajtoheshin format e ndryshme të trafikimit, të përmirësoheshin sistemet e qeverisjes dhe të luftohej korrupsioni. Strategjia e parë Ndërsektoriale për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit u miratua në vitin 2008 dhe pas përfundimit të saj qeveria shqiptare miratoi Strategjinë Ndërsektoriale për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmin 2013-2020 dhe Planin e Veprimit për vitet 2013-2016. Ndërkohë, në fund të vitit 2020 u miratua Strategjia e re kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025 dhe plani i veprimit 2021-2022.

Pavarësisht hartimit dhe zbatimit të kuadrit strategjik për të luftuar krimin e organizuar, mund të thuhet se ka munguar një qasje e mirëpërcaktuar në adresimin e këtij fenomeni. Kjo ka ardhur edhe si rezultat i mangësive të identifikuara për të kryer vlerësime sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në një metodologji të mirëpërcaktuar, në mënyrë që të bëhet e mundur dhe të reflektohen objektiva dhe tregues konkretë në përputhje me parimet e përcaktuara.

Duke qenë një kërcënim serioz edhe për vetë vendet evropiane, politikat e Bashkimit Evropian në luftën kundër krimit të organizuar janë fokusuar në përdorimin e një sërë qasjesh duke përfshirë si ato parandaluese edhe ato goditëse, të cilat kanë integruar forcimin e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë penale. Ajo çfarë mbetet përcaktuese dhe e rëndësishme në këto qasje është kryerja e analizave dhe vlerësimeve me qëllim identifikimin e kërcënimeve dhe prioriteteve për të ndërtuar më pas objektiva, aktivitete dhe masa, të cilat t'i përgjigjen sfidave aktuale që paraqet krimi i organizuar.

Në këtë kontekst edhe Shqipëria ka nevojë për të adresuar qasje të mirëpërcaktuara, të cilat të ofrojnë një kombinim të parimeve të parandalimit, goditjes, mbrojtjes, dhe rritjes së vetëdijes, me qëllim ndërhyrjen efektive kundër veprimtarive të krimit të organizuar. Gjithashtu është e rëndësishme që këto procese të jenë multidisiplinore dhe gjithëpërfshirëse, duke ndërtuar një kornizë për diskutim dhe konsultim publik të informuar, duke përfshirë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme aktorë shoqërorë dhe palë të interesuara, si dhe duke përmirësuar në këtë mënyrë debatin publik mbi politikat dhe qasjet kundër krimit të organizuar.

# Hyrje

---

Zhvillimi i krimit të organizuar përgjatë tranzicionit të thellë ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë dhe mungesa e përvojës dhe kapaciteteve për t'u trajtuar në mënyrë të përshtatshme, mundësuan që krimi i organizuar të depërtojë thellësisht në strukturën e shoqërisë shqiptare pas viteve '90, duke siguruar kështu një lloj niveli tolerance.

Shpesh individë me lidhje me krimin e organizuar janë shfaqur si biznesmenë apo edhe politikanë në komunitete, duke zbehur ndarjen midis kufijve të ligjshëm dhe të paligjshëm dhe duke e bërë edhe më të pranishëm prezencën e këtij fenomeni në shoqërinë shqiptare.

Në çdo kontekst, prania ose mungesa e krimit të organizuar lidhet me ndërthurjen e faktorëve politikë, ekonomikë, shoqërorë, mjedisorë dhe ligjorë. Secili prej këtyre faktorëve ka patur pjesën e vet në shfaqjen dhe zhvillimin e krimit të organizuar në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht.

Situata e dobët ekonomike dhe mungesa e infrastrukturës së qëndrueshme për të siguruar punësim bënë që qindra mijëra shqiptarë të migrojnë në Evropë dhe më gjerë në kërkim të kushteve më të mira të punës dhe jetesës. Shumë gjetën rrugën e tyre në këto vende duke u përfshirë në krime të ndryshme dhe kjo tendencë ka vazhduar, ndërkohë që tendenca e migrimit vazhdon të jetë relativisht e lartë tek shqiptarët edhe aktualisht.

Me strukturimin në rritje të aktiviteteve të krimit të organizuar, shumë qytetarë shqiptarë u përfshinë vitet e fundit në kultivimin e kanabisit duke zgjeruar aktivitetet e paligjshme.

Nga ana tjetër, ekonomia e pazhvilluar ka lejuar që krimi i organizuar të injektojë lehtësisht financat e tij në disa nga sektorët më të rëndësishëm ekonomikë të vendit. Duke qenë se nevoja për investime mbetet një faktor aktual, po kështu edhe rreziku nga financat e krimit të organizuar për të hyrë në ekonominë e ligjshme përbën një kërcënim të qenësishëm.

Konteksti i polarizuar politik dhe konkurrenca e fortë për pushtet midis pretendentëve politikë ka qenë dhe mbetet një nga dobësitë përmes të cilave grupet e krimit të organizuar kanë ushtruar ndikimin e tyre në politikën e vendit. Financimi i partive politike dhe nevoja për mbështetje në proceset zgjedhore, mbeten dobësi, të cilat krijojnë mundësi që krimi i organizuar të ndikojë në politikë dhe më gjerë.

Reforma në sistemin e drejtësisë e miratuar në vitin 2016 dhe ngritja e organeve të reja të drejtësisë, specifikisht Strukturës së Posaçme kundër

Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u konsiderua një hap i rëndësishëm në luftën ndaj këtij fenomeni dhe në mënyrë të veçantë në shkëputjen e zinxhirit ndërmjet krimit të organizuar dhe lidhjes së tij me aktorë kyç në institucionet publike dhe në organet e drejtësisë, si dhe me aktorët politikë.

Pavarësisht kësaj, duke patur parasysh të gjitha dinamikat e krimit të organizuar shqiptar ndër vite në Shqipëri dhe jashtë saj, si edhe karakteristikat që paraqet, është e rëndësishme të theksohet se lufta ndaj këtij fenomeni kërkon një vlerësim më të detajuar dhe si rrjedhojë konceptimin dhe krijimin e politikave, qasjeve dhe masave të cilat i përgjigjen specifikave dhe sfidave që paraqiten në rastin e Shqipërisë.



# Metodologjia

---

Metodologjia e hartuar në kuadër të përgatitjes së këtij dokumenti politikash bazohet në kryerjen e një analize, e cila është fokusuar në dy nivele kryesore.

→ Niveli i parë i analizës fokusohet në trajtimin e qasjes së Bashkimit Evropian në luftën kundër krimit të organizuar, duke theksuar dhe pasqyruar nismat dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim si dhe duke evidentuar efektivitetin e tyre përkundrejt nevojave të paraqitura.

→ Niveli i dytë i analizës fokusohet në trajtimin e qasjes që Shqipëria ka adoptuar në luftën kundër krimit të organizuar, në mënyrë të veçantë atë pas viteve '90. Kjo analizë synon të identifikojë dhe vlerësojë mangësitë e hasura në mënyrën e ndërtimit të kësaj qasjeje, me qëllim gjenerimin e rekomandimeve përkundrejt nismave dhe masave të ndërmarra në nivel të Bashkimit Evropian.

Bazuar në metodologjinë e ndjekur dhe analizën e kryer, ky dokument politikash ndahet në 4 kapituj kryesorë.

**Kapitulli I:** prezanton një panoramë të përgjithshme të tendencave kryesore të krimit të organizuar në Shqipëri, tipareve kryesore të organizatave shqiptare të krimit të organizuar brenda Shqipërisë dhe jashtë saj, si dhe aktiviteteve kryesore kriminale të ndërmarra nga këto grupe.

**Kapitulli II:** paraqet disa nga vlerësimet kryesore ndërkombëtare në lidhje me krimin e organizuar shqiptar. Këto vlerësime pasqyrojnë disa elementë të rëndësishëm që lidhen me shkallën dhe shtrirjen e krimit të organizuar, si dhe vlerësimin e rezultateve të arritura në luftën fenomenit.

**Kapitulli III:** përshkruan hapat dhe masat që Bashkimi Evropian ka miratuar në luftën kundër krimit të organizuar gjatë viteve të fundit, si një nga kërcënimet më serioze. Nëpërmjet përshkrimit të këtyre masave, ky kapitull synon të vlerësojë qasjen e BE-së në luftën kundër krimit të organizuar.

**Kapitulli IV:** trajton qasjen e ndjekur nga Shqipëria në luftën kundër krimit të organizuar duke e vënë theksin në mënyrë të veçantë tek kuadri strategjik. Ky kapitull ka si qëllim të evidentojë disa nga mangësitë e kësaj qasjeje duke e krahasur atë me masat e ndërmarra nga Bashkimi Evropian. Kjo analizë krahasuese është realizuar për të theksuar nevojën që ka Shqipëria për të zhvilluar dhe përshtatur një përgjigje sa më efektive kundër këtij fenomeni.

Metodologjia e përdorur i është referohet të dhënave/statistikave zyrtare të institucioneve të ndryshme ligjzbatuese në Shqipëri, si edhe raporteve të institucioneve ndërkombëtare. Në plotësim të këtyre të dhënave janë përdorur edhe informacione dhe të dhëna të tjera dytësore nga burime të jashtme.

# I. Krimi i organizuar: Relevanca dhe Trendet

---

Krimi i organizuar vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore për sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Një pjesë e konsiderueshme e grupeve të krimit të organizuar janë **përfshirë në ekonominë e ligjshme** të vendit, duke bërë që aktivitete si pastrimi i parave apo trafikimi i mallrave me akcizë të lartë dhe produkteve të falsifikuara të jenë mjaft prezente.

Gjithashtu, gjithnjë dhe më tepër grupet e krimit të organizuar po përdorin **teknologjinë** për të shmangur hetimet, sikurse dhe planifikimin dhe kryerjen e operacioneve të tyre, të cilat vitet e fundit janë bërë më të larmishme, por njëkohësisht edhe më të vështira për t'u zbuluar.

**Shtrirja transnacionale** e krimit të organizuar ka bërë gjithashtu që ndarja ndërmjet këtyre aktiviteteve të kryera nën juridiksionin shqiptar dhe atyre të kryera brenda juridiksionit të zonës së BE-së të bëhen gjithnjë e më pak të dallueshme.

**Zhvillimi, sofistikimi dhe trendet** e krimit të organizuar kanë sjellë një shtim të vëllimit të veprimtarive kriminale, si edhe risi në strukturimin organizativ dhe *modus operandi*-n e këtyre grupeve.

## Korrupsioni dhe ndikimi në sektorin publik

Korrupsioni në sektorin publik lidhet me abuzimin e pushtetit dhe kompetencave që ky i fundit ka, duke ndikuar në mënyrë të paligjshme dhe duke përdorur rryshfetin dhe shantazhet në funksion të aktiviteteve të ndryshme kriminale.

**Prania e korrupsionit**, si një tipar kryesor i ekonomive në tranzicion, ka qenë një nga **faktorët kryesorë mundësues** që ka krijuar një ekosistem të favorshëm për krimin e organizuar.

Masat më aktive të përdorura nga grupet e krimit të organizuar kanë qenë **depërtimi i sistemeve qeveritare përmes rekrutimit në funksione politike dhe administrative**. Miratimi i ligjit për dekriminalizimin në vitin 2015 ka për qëllim përmbysjen e kësaj tendence, duke larguar zyrtarët publikë me të dhëna kriminale nga Parlamenti dhe institucionet shtetërore.<sup>1</sup>

Në mënyrë të ngjashme, proceset e verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>2</sup> dhe të oficerëve të policisë<sup>3</sup> - të cilat përfshijnë shqyrtimin e zyrtarëve

---

<sup>1</sup> Ligji Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

<sup>2</sup> Ligji Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

<sup>3</sup> Ligji Nr. 12/2018 datë 5.3.2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”

për lidhje të papërshtatshme me krimin e organizuar - u ndërmorrën në përgjigje të rritjes së ndikimit të krimit të organizuar në sistemin gjyqësor.

Krijimi i Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar së bashku me Byronë Kombëtare të Hetimit erdhën si përgjigje për të luftuar dhe përmbysur një nivel kaq të lartë depërtimi të krimit të organizuar.

Përveç korrupsionit dhe dhënies së mbështetjes financiare për proceset zgjedhore, grupet kriminale të krimit të organizuar janë raportuar të shantazhojnë edhe politikanët me prova kompromentuese.<sup>4</sup>

## Përdorimi i Strukturave të Ligjshme të Biznesit

Operimi brenda ekonomisë së ligjshme përmes blerjes së aseteve ka qenë një nga tiparet kryesore të krimit të organizuar në Shqipëri. Ndërkohë që grupet e krimit të organizuar rritën fuqinë e tyre ekonomike duke fituar shuma të konsiderueshme nga aktivitetet e paligjshme, ato **depërtuan në ekonominë e ligjshme** nëpërmjet investimeve, pastrimit të parave dhe krijimit të strukturave të ligjshme të biznesit.<sup>5</sup>

Aktualisht prania e grupeve të krimit të organizuar është vënë në dukje në industrinë fitimprurëse ku përfshihen pasuritë e paluajtshme, turizmi, ndërtimi etj.<sup>6</sup>

Grupet shqiptare të krimit të organizuar janë bërë gjithnjë e më aktive në krijimin e bizneseve që përdoren si fronte për të pastruar paratë, për të mbuluar veprimtari të mëtejshme të paligjshme ose për të dyja së bashku. Gjithashtu, ka prova të fitimit të grupeve shqiptare të krimit të organizuar përmes kompanive të tyre duke përdorur **fondet publike përmes procedurave të tenderimit**.

Ligji për Prokurimin Publik është ndryshuar së fundmi për të parandaluar aksesin ndaj fondeve publike të krimit të organizuar përmes futjes së kriterëve të përjashtimit për kandidatët dhe ofertuesit të lidhur me aktivitetet e krimit të organizuar.<sup>7</sup>

Sektorët e biznesit si bankat, pasuritë e paluajtshme, kontabiliteti, lojërat e fatit, shërbimet e transferimit të parave janë konsideruar nga struktura permanente e Këshillit të Evropës Moneyval si sektorë me dëshmi të investimeve të krimit të organizuar në Shqipëri.<sup>8</sup>

<sup>4</sup> Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, “Zonat problematike të krimit të organizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor: Identifikimi dhe analizimi i pikave të dobëta në zona të caktuara në një kontekst rajonal”, Maj 2019: <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-Albanian-13Jun1110-Web.pdf>

<sup>5</sup> Fabian Zhilla, Besfort Lamallari; “Evoluimi i strukturave të organizuara kriminale në Shqipëri”, OSFA 2016: [http://www.osfa.al/sites/default/files/evolution\\_of\\_the\\_albanian\\_organized\\_crime\\_groups.pdf](http://www.osfa.al/sites/default/files/evolution_of_the_albanian_organized_crime_groups.pdf)

<sup>6</sup> Shërbimi Informativ i Shtetit, Raport Publik 2019: <https://www.shish.gov.al/files/Raporti%20publik.pdf>

<sup>7</sup> Neni 45, Ligji Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

<sup>8</sup> Anti-money laundering and counter-terrorist financing measures: Albania, Fifth Round Mutual Evaluation Report. Moneyval (2018)7: <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/16808ff138>

## Përshtatshmëria dhe fleksibiliteti

**Përshtatshmëria** është një nga karakteristikat kryesore të grupeve të krimit të organizuar, e cila lidhet me aftësinë për të përshtatur aktivitetet kriminale ose proceset e punës ndaj ndryshimeve në mjedisin e punës, për të shfrytëzuar tregjet e ligjshme dhe të paligjshme si dhe aftësitë që kanë të bëjnë me inovacionin dhe proaktivitetin.

**Procesi i adaptimit** ka ndikuar në strukturën, aktivitetet dhe mënyrën e funksionimit të këtyre grupeve. Aftësia e tyre për t'u përshtatur përbën një kërcënim të nivelit të lartë. Ky tipar i krimit të organizuar u evidentua edhe përgjatë pandemisë Covid-19. Pavarësisht kufizimeve të vendosura, grupet kriminale jo vetëm që ri-rregulluan dhe përshtatën mënyrën e operimit të aktiviteteve të tyre, por në të njëjtën kohë shfrytëzuan mundësi të reja të dala si pasojë e krizës shëndetësore globale.<sup>9</sup>

Krijimi i një **modeli biznesi më vete**, në përputhje me nevojat dhe dinamikat e tregut, përbën gjithashtu një nga tiparet e grupeve të krimit të organizuar.

## Ekspertiza

Grupet shqiptare të krimit të organizuar vlerësohet të jenë shumë të adaptueshme, duke kombinuar **ekspertizën dhe përfitimin** për të arritur objektivat e tyre dhe për të përparuar në tregjet e konkurrencës.

Pozicioni i Shqipërisë në rrugën ballkanike të dërgesave të drogës drejt vendeve perëndimore, ka kontribuar në zhvillimin e ekspertizës të grupeve të krimit të organizuar për fshehjen e drogërave, zhvillimin e aftësive të transportit dhe rrjetëzimit transkufitar.

Grupet e krimit të organizuar kanë zhvilluar **aftësi dhe planifikim** për të kryer operacione komplekse. Përpos ekspertizës së zhvilluar për të kryer veprimtari të paligjshme, grupet e krimit të organizuar kanë zhvilluar gjithashtu **ekspertizë për mbrojtjen e veprimtarive të tyre nga zbatimi i ligjit dhe konkurrenca**.

Zhvillimi i teknologjive dhe aftësia e tyre ka lejuar që grupe të krimit të organizuar të përdorin **zgjidhje të ndryshme teknologjike** për të mbrojtur ambjentet, por edhe për të kontrolluar lëvizjet e organeve të zbatimit të ligjit. Për t'u kujdesur për aktivitetet e tyre, grupet e krimit të organizuar përdorin burimet e tyre për të punësuar profesionistë më aftësi, si avokatë apo ekonomistë.

---

<sup>9</sup> Vlerësim i Kërcënimit të Krimit të Rënda dhe të Organizuar të Bashkimit Evropian (EU SOCTA 2021), EUROPOL: [https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/socta2021\\_1.pdf](https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/socta2021_1.pdf)

## Efektet e krimit të organizuar

Përmes pranisë së tij krimi i organizuar ka prodhuar efekte të shumta negative në shoqëri, ekonomi dhe proceset politike. Një nga efektet më të pafavorshme, nëse jo më i dëmshmi, që rezulton nga aktivitetet e krimit të organizuar është **dëmi fizik dhe psikologjik** i shkaktuar ndaj shumë individëve të trafikuar, të detyruar të prostitujnë ose/dhe punës së detyruar, si dhe viktimave të përdorimit të drogës.

Një efekt tjetër negativ është **depërtimi i krimit të organizuar në ekonominë e ligjshme**, e cila ka dëmtuar konkurrencën e lirë, motorrin e ekonomisë së tregut, ka rritur kostot e biznesit dhe ka dëmtuar klimën e përgjithshme të biznesit.

Efektet negative shtesë përfshijnë **korrupsionin** e sistemeve administrative dhe ato të drejtësisë penale dhe ngadalësimin e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian. Përmes pranisë së shtuar në nivelet ekonomike dhe shoqërore, krimi i organizuar ka vënë nën presion **sistemet e qeverisjes ekonomike dhe zbatimin e shtetit ligjor**, duke e detyruar vendin të ndër marrë reforma të kushtueshme, përfshirë reformën gjithëpërfshirëse në sektorin e drejtësisë të miratuar në vitin 2016.

Duke qenë një nga përparësitë kryesore që duhet të përmbushet në mënyrë që Shqipëria të bëjë përparim në procesin e pranimit në BE, lufta kundër krimit të organizuar ka konsumuar **kohë dhe burime të vlefshme** që mund t'i kushtoheshin fronteve të tjera pa dëmtuar reputacionin ndërkombëtar të vendit.

## II. Shkalla e Përgatitjes së Shqipërisë për të adresuar Krimin e Organizuar


Si vend kandidat në pritje të fillimit të negociatave të anëtarësimit, lufta kundër krimit të organizuar vazhdon të mbetet një nga treguesit kryesorë për përparimin e Shqipërisë drejt BE-së.

Megjithëkëtë, është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim, vlerësimet që lidhen me rezultatet e Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar mbeten ende të dobëta dhe në tërësi rezultoni që lufta ndaj krimit të organizuar ka nevojë të forcohet më tej.

### Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë

Në Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë gjatë 4 viteve të fundit (2018-2021) niveli i përgatitjes së vendit në luftën kundër krimit të organizuar ka mbetur i njëjtë (*njëfarë niveli përgatitjeje*).<sup>10</sup>

Rekomandimet më të fundit të Raport Progresit për vitin 2021 e vënë theksin në vazhdimin e forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, krijimin e një zyre/agjencie për rikuperimin e aseteve si edhe forcimin e zbatimit të ligjit ndaj krimit kibernetik për të rritur zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale (Tabela 1).



**Figura 1:** Vlerësimet në lidhje me nivelin e përgatitjes së Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar (2018-2021)

**Burimi:** Komisioni Evropian (Raportet për Shqipërinë)

<sup>10</sup> Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/negotiations-status/albania\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/negotiations-status/albania_en)

0	Fillestar
1	Fillestar/disi (njëfarë niveli)
2	Disi (njëfarë niveli)
3	Disi (njëfarë niveli)/moderuar
4	Moderuar
5	Moderuar/i mirë
6	I mirë

0	Regres
1	Asnjë përparim
2	Përparim i kufizuar
3	Pak përparim
4	Përparim i mirë

Viti	Përgatitja	Përparimi	Rekomandimet në Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë
2021	Njëfarë niveli përgatitjeje	Përparim i mirë	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ të vazhdojë forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, duke përfshirë bashkëpunimin me shtetet anëtare të BE-së, si dhe me agjencitë e BE-së, duke përfshirë EUROPOL-in dhe EUROJUST-in; numri i agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit që kanë akses në SIENA duhet të zgjerohet më tej;</li> <li>→ të krijojë pa vonesë ose të caktojë një zyrë/agjenci për rikuperimin e aseteve në përputhje me acquis të BE-së që është përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar;</li> <li>→ të forcojë reagimin efektiv të zbatimit të ligjit ndaj krimit kibernetik për të rritur zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale.</li> </ul>
2020	Njëfarë niveli përgatitjeje	Përparim i mirë	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ duhet të vazhdojë të forcojë luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë përmes bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së, si dhe EUROPOL-in;</li> <li>→ duhet të miratojë një strategji të re dhe një plan veprimi për drogën, të mbushë hendekun legjislativ për prekursorët e drogës dhe intensifikimin e luftës kundër trafikut të drogës;</li> <li>→ duhet të miratojë një strategji kundër krimit kibernetik dhe të krijojë një përgjigje më efektive të zbatimit të ligjit, e cila përqendrohet tek ndalimi, gjurmimi dhe ndjekja penale e kriminelëve kibernetikë dhe të trajtojë fenomenin në rritje të pornografisë së fëmijëve online.</li> </ul>
2019	Njëfarë niveli përgatitjeje	Përparim i mirë	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ të bëhen përparime të tjera të dukshme në goditjen e grupeve të organizuara kriminale, duke dhënë dënime parandaluese, duke marrë të ardhurat që rrjedhin nga krimi përmes konfiskimit të pasurive dhe duke adresuar pastrimin e parave;</li> <li>→ të krijohet ose të caktohet një zyrë/agjenci e rikuperimit të aseteve në përputhje me acquis-in e BE-së, përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e pasurive kriminale;</li> <li>→ të miratohet strategjia e re dhe plani i veprimit për drogën, të plotësohet boshllëku ligjor mbi prekursorët e drogave dhe të intensifikohet lufta kundër trafikimit të drogave të rënda;</li> <li>→ të miratohet një strategji për krimin kibernetik dhe të krijohet një sistem reagimi ligjzbatues më efektiv, me fokus zbulimin, gjurmimin dhe ndjekjen penale të kriminelëve kibernetikë;</li> </ul>
2018	Njëfarë niveli përgatitjeje	Pak Përparim	<ul style="list-style-type: none"> <li>→ progres i mëtjshëm drejt krijimit të regjistrit të të dhënave solide të hetimeve proaktive (<i>solid track record</i>), ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare kundër grupeve të krimit të organizuar; kjo duhet të përfshijë intensifikimin e hetimeve dhe ndjekjen penale të anëtarëve të nivelit të lartë të grupeve të krimit të organizuar;</li> <li>→ krijimi, pajisja dhe ngritja e kapaciteteve të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit për të luftuar krimin e organizuar dhe për të siguruar koordinimin ndërmjet strukturave përkatëse ekzistuese;</li> <li>→ intensifikimi i luftës kundër pastrimit të parave nëpërmjet përdorimit më efektiv të inteligjencës penale, zbulimit, identifikimit, gjurmimit, ngrirjes dhe konfiskimit të produkteve të krimit; hartimi i raporteve të transaksioneve të dyshimta të pranueshme si provë në gjykatë; prezantimi/futja e koncepteve të konfiskimit të zgjeruar dhe kufirit financiar në transaksionet me para të gatshme; dhe forcimi i kapacitetit të autoriteteve ligjzbatuese për të trajtuar mashtrimin tatimor dhe evazionin fiskal;</li> <li>→ të krijohet një agjenci e centralizuar përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale (Agjencia e Rikuperimit të Aseteve) në mënyrë që të rritet më tej efektiviteti i sistemit kombëtar të rikuperimit të aseteve dhe të lehtësohet bashkëpunimi operacional me zyrat për rikuperimin e aseteve në shtetet anëtare të BE-së.</li> </ul>

**Tabela 1:** Rekomandimet në lidhje me nivelin e përgatitjes dhe përparimit të Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar (2018-2021)

*Burimi:* Komisioni Evropian (Raportet për Shqipërinë)



## Raporti për Trafikimin e Personave

Një tjetër vlerësim i rëndësishëm në lidhje me arritjen e rezultateve të Shqipërisë në fushën e krimit të organizuar është Raporti vjetor i Departamentit të Shtetit të SHBA-së në lidhje me Trafikimin e Personave.<sup>11</sup>

Raporti i ndan vendet në tre nivele (*tiers*):

- 1) Vende e territore, qeveritë e të cilave përputhen plotësisht me standardet minimale të kërkuara;
- 2) Vendet dhe territore, qeveritë e të cilave nuk përputhen plotësisht me standardet minimale, por që po bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të ardhur në përputhje me to;
- 3) Vende që nuk përputhen plotësisht me standardet minimale dhe nuk po bëjnë përpjekje të konsiderueshme për një gjë të tillë.

Megjithëse raporti i vitit 2021 vlerëson përpjekjet e Shqipërisë në luftën kundër trafikimit, theksohet se qeveria e Shqipërisë nuk i përmbushi plotësisht standardet minimale për eliminimin e trafikimit, duke qendruar sërish në nivelin 2.<sup>12</sup>

Raporti thekson përpjekjet e qeverisë shqiptare që lidhen me parandalimin e trafikimit dhe zbatimin e planit kombëtar të veprimit për vitet 2018-2020, si edhe caktimin e një fondi prej 4.87 milionë dollarësh për zbatimin e tij.

Megjithatë duhet theksuar se pavarësisht këtyre përpjekjeve, gjykatat shqiptare nuk dënuan asnjë trafikant (ndërsa kishin dënuar pesë të tillë gjatë vitit 2019). Gjykatat e apelit shqyrtoi dhe konfirmoi vendimet për 3 trafikantë (po aq edhe në 2019). Gjithashtu theksohet se qeveria i uli përpjekjet e strukturave të zbatimit të ligjit në këtë drejtim. Raporti rekomandon hetimin me forcë, ndjekjen penale dhe dënimin e trafikantëve, përfshirë atë të zyrtarëve bashkëpunëtorë.

Siç evidentohet edhe nga të dhënat e grafikut më poshtë, megjithëse në Shqipëri pas vitit 2017 numri i viktimave të trafikimit<sup>13</sup> ka pësuar një rënie të ndjeshme, numri i viktimave të mundshme të trafikimit<sup>14</sup> ka pësuar rritje, duke theksuar në këtë

<sup>11</sup> Departamenti i Shtetit të SHBA, Raportet për Trafikimin e Personave (2016-2021): <https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/>

<sup>12</sup> Po aty, Raporti për Trafikimin e Personave 2021: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/09/TIPR-GPA-upload-07222021.pdf>


<sup>13</sup> “Viktimë e trafikimit” i referohet të njëjtit kuptim sipas gërmës “e” të nenit 4, të Ligjit Nr. 9642 datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”

<sup>14</sup> “Viktimë e mundshme e trafikimit” (VMT) është personi, për të cilin/të cilën, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar, bazuar në treguesit/indiktorët/dritën e rrethanave të veçanta të rasteve, në të cilën, të paktën tre ose më shumë elementë përbëjnë dyshimin e arsyeshëm se personi mund të jetë trafikuar.

- Ministria e Brendshme, “Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”, 2018: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/PROCEDURAT-STANDARDE-T%C3%8B-VEPRIMIT-PER-MBROJTJEN-E-VIKTIMAVE-TE-TRAFIKIMIT.pdf>



mënyrë prezencën e tendencave shqetësuese që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.



*Grafik 1:* Numri i Viktimave të Trafikimit (VT) dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit (VMT) në Shqipëri (2016-2020)

*Burimi:* Raportet vjetore të Departamentit të Shtetit të SHBA për Trafikimin e Personave dhe Raportet vjetore për zbatimin e Planeve Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave

## Indeksi Global për Krimin e Organizuar 2021

Vlerësime të tjera ndërkombëtare siç është Indeksi Global për Krimin e Organizuar vënë në dukje gjithashtu shtrirjen transnacionale të grupeve shqiptare të krimit të organizuar si edhe theksojnë shtrirjen e aktiviteteve të tyre kriminale edhe jashtë vendit, të cilat konsistojnë kryesisht në trafikimin e narkotikëve, trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandën e emigrantëve.<sup>15</sup>

Indeksi Global për Krimin e Organizuar 2021 analizon mënyrën se si vepron krimi i organizuar në 193 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara sipas 2 matricave: (i) kriminaliteti i vlerësuar me pikë nga 1 deri në 10 (niveli i krimit të organizuar nga më i

<sup>15</sup> Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Indeksi Global për Krimin e Organizuar 2021: <https://ocindex.net/country/albania>

ulëti tek më i larti), dhe (ii) rezistenca ndaj krimit të organizuar me pikë nga 1 deri në 10 (niveli i rezistencës ndaj krimit të organizuar nga më i ulëti tek më i larti).

Gjatë vitit 2021, Shqipëria shënoi 5.63 pikë në renditjen për vlerësimin e kriminalitetit, duke u renditur në vend të 61 nga 193 shtete, në vend të 9 nga 44 shtete evropiane dhe në vend të 6 nga 17 shtete të Evropës Qëndrore dhe Lindore. Ndërkohë që në lidhje me vlerësimin e rezistencës ndaj krimit të organizuar Shqipëria shënoi 5.04 pikë, duke u renditur e 87 nga 193 shtete, e 36 nga 44 shtete evropiane dhe e 10 nga 17 shtete të Evropës Qëndrore dhe Lindore.

Indeksi thekson disa vlerësime problematike ndaj Shqipërisë, duke e konsideruar këtë të fundit si një **vend burimi dhe tranziti për trafikimin e qenieve njerëzore dhe vend tranziti për migrantët e parregullt** me destinacion Evropën, ndërkohë që aktorët kriminalë shqiptarë dyshohet se janë përgjegjës për një numër të madh viktimash trafikimi të zbuluara në Evropën Perëndimore. Gjithashtu, indeksi thekson se grupet shqiptare të krimit të organizuar janë të përfshirë në operacionet ndërkombëtare dhe vendase të kontrabandës së qenieve njerëzore dhe bashkëpunojnë me kontrabandistë të tjerë në vendet përreth për të lehtësuar udhëtimet.

Edhe në lidhje me trafikimin e narkotikëve Shqipëria konsiderohet një **vend kyç tranzit për heroinën, si dhe kokainën** e trafikuar nga Amerika Latine, ndërkohë që aktorët kriminalë shqiptarë luajnë gjithashtu role qendror në tregjet e heroinës dhe kokainës në Evropë. Këto grupe vlerësohet të jenë të përfshira edhe në ruajtjen dhe shpërndarjen e kokainës, si dhe të kenë konsoliduar gjithnjë e më shumë ndikimin e tyre mbi tregtarët me shumicë dhe pakicë në të gjithë kontinentin. Si rezultat, grupet shqiptare të krimit të organizuar kanë arritur të kontrollojnë një pjesë të konsiderueshme të tregtisë së kokainës në Evropë.

Shqipëria konsiderohet gjithashtu një vend tranzit, përmes rrugës ballkanike, për heroinën e trafikuar në Evropë me prejardhje nga Turqia, Irani, Afganistani dhe Pakistani. Trafikimi ndërmerret nga aktorë të stilit mafioz dhe rrjete kriminale që bashkëpunojnë me aktorë të tjerë kriminalë të përfshirë në **zinxhirin e furnizimit** të heroinës. Pjesa më e madhe e heroinës trafikohet në Shqipëri nga toka, përmes Maqedonisë së Veriut, por **laboratorët e përpunimit të heroinës** janë zbuluar edhe brenda vendit nga policia shqiptare.

Indeksi thekson gjithashtu se Shqipëria ka qenë një nga prodhuesit më të mëdhenj të kanabisit në Evropë për të paktën një dekadë. Ndonjëse vitet e fundit kultivimi i tij ka rënë në mënyrë drastike, Shqipëria vazhdon të jetë një burim i rëndësishëm i kanabisit në drejtim të BE-së, me drogën që thuhet se transportohet nga deti nëpërmjet Italisë dhe nga toka përmes Greqisë dhe Malit të Zi.

**Lidhja** e grupeve të krimit të organizuar **me aktorë shtetërore**, duke përfshirë zyrtarë të korruptuar të policisë dhe gjyqësorit si dhe duke përfituar mbrojtje politike, është një nga vlerësimet kryesore që evidentohet në këtë Indeks. Shpesh këto grupe përfshihen në biznese të ligjshme dhe madje anëtarë të tyre janë emëruar në poste politike në nivele të ndryshme brenda aparatit shtetëror.

Grupet shqiptare të krimit të organizuar kontrollojnë tregjet kriminale për drogën dhe trafikun e qenieve njerëzore dhe janë pozicionuar si disa nga organizatat kriminale më të fuqishme në Evropë duke bashkëpunuar me rrjete kriminale me një prezencë të theksuar në Belgjikë, Holandë dhe Britaninë e Madhe.<sup>16</sup>

**Mjedisi ekonomik dhe ai financiar** i vendit konsiderohen gjithashtu si faktorët kryesorë për ti bërë një rezistencë të fortë krimit të organizuar. **Korrupsioni, kornizat e dobëta rregullatore** dhe një **ekonomi** e konsiderueshme **informale** e bëjnë Shqipërinë të pambrojtur ndaj pastrimit të parave. Për shkak të informalitetit, numri i rasteve të zbuluara të pastrimit të parave mbetet ende i ulët.

Jashtë ekonomisë informale, shumë projekte në shkallë të gjerë të pastrimit të parave janë “promovuar” si projekte prestigjioze të infrastrukturës publike-private, të tilla si stadiumet e futbollit, teatrot dhe qendrat tregtare. Projekte të tilla shpesh përfshijnë politikanë të korruptuar shqiptarë dhe aktorë ndërkombëtarë, duke evidentuar shkallën në të cilën krimi i organizuar është në gjendje të kapë institucionet shtetërore.

Pavarësisht masave të ndërmarra, zbatimi mbetet një sfidë e rëndësishme, veçanërisht në lidhje me konfiskimin e asetëve të sekuestruara. Shqipëria u rendit në listën gri nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF)<sup>17</sup> në fillim të vitit 2020 për shkak të paaftësisë së saj për të adresuar mangësitë strategjike në regjimin e saj kundër pastrimit të parave.

## Raporti Botëror i Drogave

Edhe në raportin vjetor të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC), veprimtaria e grupeve shqiptare të krimit të organizuar cilësohet si mjaft

---

<sup>16</sup> Agjencia Kombëtare e Krimit në Britani (NCA), “Vlerësim Kombëtar Strategjik i Krimit të Rëndë dhe Organizuar”: [https://www.nationalcrimeagency.gov.uk/who-we-are/publications?limit=100&sort=created\\_on&search=national%20strategic%20assessment&direction=desc](https://www.nationalcrimeagency.gov.uk/who-we-are/publications?limit=100&sort=created_on&search=national%20strategic%20assessment&direction=desc)

<sup>17</sup> Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) është një organ ndërqeveritar i themeluar në vitin 1989 nga Ministrat e vendeve anëtare të G7.

problematike. Raporti citon rrjetet shqiptare si të rëndësishme në trafikun e kokainës, duke zbatuar **modelin e biznesit "end to end"** - model që përjashton palët e treta dhe e menaxhon vetë procesin nga fillimi në fund.<sup>18</sup>

Shqipëria përmendet gjithashtu si **shteti kryesor i origjinës së kanabisit** në Europë dhe i gjashti në nivel botëror për periudhën 2015-2019.

Vet shqiptarët zënë një peshë të konsiderueshme të shtetasve të huaj që janë arrestuar në lidhje me kapjet individuale të kokainës, të vlerësuara sipas madhësisë së sasisë së kapur. 25% e arrestimeve në nivelin e parë të tregtimit janë me origjinë nga Shqipëria.

Në tërësi dhe bazuar në vlerësimet e sipërmendura, mund të thuhet se, ndërkohë që volumi dhe veprimtaritë e krimit të organizuar kanë pësuar rritje dhe shtrirje, Shqipëria ka ende nevojë të theksuar për të adresuar në mënyrë më efikente përgjigjen e saj në luftën kundër krimit të organizuar dhe për t'u përgatitur në përputhje me sfidat aktuale që paraqet ky fenomen edhe në vendet e Bashkimit Evropian.

---

<sup>18</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC), Raporti Botëror i Drogave 2021: <https://www.unodc.org/unodc/en/data-and-analysis/wdr2021.html>

### III. Qasja e Bashkimit Evropian në luftën kundër Krimin të Organizuar

---

Krimi i organizuar dhe dinamikat e tij ndër vite për t'iu përshtatur ndryshimeve të vazhdueshme mbeten një problem serioz edhe për vetë vendet e Bashkimit Evropian.

Nga të dhënat e publikuara nga Komisioni Evropian, krimi i organizuar i kushton ekonomisë së Bashkimit Evropian ndërmjet 218 dhe 282 miliardë euro në vit.<sup>19</sup> Të ardhurat e krimit të organizuar brenda BE-së vlerësohen të jenë rreth 110 miliardë euro në vit.

Në vitin 2017 rreth gjysma e grupeve të krimit të organizuar në Bashkimin Evropian ishin të përfshira në disa lloje aktivitesh kriminale. Më shumë se 80% e rrjeteve kriminale aktive në BE përdorin strukturat e ligjshme të biznesit për aktivitetet e tyre kriminale, ndërkohë që evidentohet një lidhje e fortë e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në këtë kontekst, për të përmirësuar qasjen në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, Bashkimi Evropian gjithnjë e më shumë evidentoi nevojën për zhvillimin dhe **konsolidimin e mëtejshëm të strukturave dhe instrumenteve ekzistues**, si dhe nevojën për të zhvilluar **qasje të qëndrueshme, shumëdimensionale dhe të integruara** në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë, efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies kundrejt luftimit të këtyre fenomeneve.

Politikat e Bashkimit Evropian në luftën kundër krimit të organizuar janë fokusuar në përdorimin e një sërë qasjesh duke përfshirë nga ato parandaluese dhe goditëse, të cilat kanë integruar forcimin e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë penale.

#### Qasja parandaluese

Qasja e kombinuar e përdorimit të ligjit administrativ me atë penal filloi të zbatohet në Evropë në vitet 1990. Parandalimi i krimit u bë një çështje e rëndësishme e Bashkimit Evropian me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit.

Rrjeti Evropian për Parandalimin e Krimin (EUCPN), i cili u themelua në vitin 2001, synon të stimulojnë dhe të lehtësojë një rrjet pikash kontakti, kompetente në fushën

---

<sup>19</sup> Komisioni i Bashkimit Evropian, “Strategjia e Bashkimit Evropian për të luftuar Krimin e Organizuar 2021-2025”: [https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/12735-Fighting-organised-crime-EU-strategy-for-2021-25\\_en](https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/12735-Fighting-organised-crime-EU-strategy-for-2021-25_en)

administrative, për të trajtuar fenomenin e grupeve të krimit të organizuar duke marrë parasysh nevojat kombëtare dhe rrethana të veçanta.

Gjithashtu nën Presidencën Hollandeze (gjatë semestrit të parë të vitit 2016), për herë të parë u ra dakord nga shtete anëtare për një përkufizim mbi qasjen administrative. Ky përparim në nivel komunitar lidhet ngushtë edhe me rëndësinë që i jep Holanda promovimit dhe zbatimit të parimit të shtetit të së drejtës.

Në Konkluzionet e Këshillit mbi qasjen administrative për parandalimin dhe luftimin e krimit të rëndë dhe të organizuar të miratuara nga Ministrat e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme, shtetet anëtare u ftuan të kombinojnë elementë të qasjes administrative, të cilat më pas u zbatuan nga një sërë shtetesh.<sup>20</sup>

## Hartimi i Strategjive përmes Analizave/Mlerësimeve

Për shkak të kompleksitetit të krimit të organizuar dhe nevojës për t'a adresuar atë në dokumente të tilla si strategjitë, kryerja e analizave dhe vlerësimeve efektive përbën një element shumë të rëndësishëm.


Këto analiza strategjike të krimit të organizuar mbulojnë të paktën **tre dimensione kryesore**, të cilat përfshijnë:<sup>21</sup>

1. **Grupet e organizuara kriminale** të përfshira në krimin e organizuar, përfshirë strukturën, aktivitetet dhe marrëdhëniet bashkëpunuese dhe konkurruese, përfshirë me grupet e tjera kriminale të organizuara të vendosura brenda dhe jashtë vendit;
2. **Tregjet e krimit të organizuar**, më konkretisht, sektorët, mallrat, shërbimet, mundësuesit dhe infrastrukturat e ndryshme që së bashku përbëjnë ekonominë kriminale; si edhe
3. **Faktorët strukturorë dhe mjedisorë** të krimit të organizuar. (Analiza PESTLE)<sup>22</sup>

<sup>20</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian, 9061/16 “Draft Konkluzionet e Këshillit mbi qasjen administrative për të parandaluar dhe luftuar krimin e rëndë dhe të organizuar”: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-9061-2016-INIT/en/pdf>

<sup>21</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), “Udhëzues i Strategjisë për Krimin e Organizuar për zhvillimin e strategjive me ndikim të lartë”: [https://sherloc.unodc.org/cld/uploads/pdf/Strategies/Toolkit\\_-\\_Albanian.pdf](https://sherloc.unodc.org/cld/uploads/pdf/Strategies/Toolkit_-_Albanian.pdf)

<sup>22</sup> Analiza PESTLE studion faktorët kryesorë të jashtëm (Politikë, Ekonomië, Sociologjikë, Teknologjik, Ligjorë dhe Mjedisorë)



*Grafik 2:* Komponentët e analizave efektive në funksion të hartimit të strategjive kundër krimit të organizuar

*Burimi:* Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC)

Së bashku, këta komponentë të ndryshëm mund të çojnë në një kuptim më të nuancuar të ekonomisë politike të krimit të organizuar, si dhe të ndihmojnë për të kuptuar rreziqet dhe kompromiset e ndryshme që lidhen me ndërhyrjet dhe politikat e ndryshme të përfshira në strategji.<sup>23</sup>

## Analiza e kërcënimeve aktuale dhe atyre të ardhshme (SOCTA)


Në masat në luftën kundër krimit të organizuar, në nëntor të vitit 2010, Këshilli i Bashkimit Evropian vendosi mbi krijimin dhe zbatimin e “Ciklit të Politikave të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda ndërkombëtare”, i njohur shkurtimisht si **EMPACT** (Platforma Shumëdisiplinore Evropiane Kundër Kërcënimeve Kriminale) duke krijuar në këtë mënyrë një metodologji të qartë në drejtim të zbatimit dhe vlerësimit të prioriteteve në luftën kundër krimit të organizuar.<sup>24</sup>

<sup>23</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), “Udhëzues i Strategjisë për Krimin e Organizuar për zhvillimin e strategjive me ndikim të lartë”: [https://sherloc.unodc.org/cld/uploads/pdf/Strategies/Toolkit\\_-\\_Albanian.pdf](https://sherloc.unodc.org/cld/uploads/pdf/Strategies/Toolkit_-_Albanian.pdf)

<sup>24</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian, “Draft Konkluzionet e Këshillit për krijimin dhe zbatimin e një cikli politikash të BE-së për krimin e organizuar dhe krimet e rënda ndërkombëtare” 15358/10: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-15358-2010-INIT/en/pdf>

Ndër hapat kryesorë që parashikon EUROPOL, fillimisht hartohet i ashtuquajtimi Vlerësimin e Kërcënimit të Krimin të Rënda dhe të Organizuar të Bashkimit Evropian (EU SOCTA), mbi bazën e të dhënave të gjera të ofruara nga shtetet anëtare dhe palë të tjera të interesuara. SOCTA identifikon kërcënimet kryesore kriminale që prekin vendet e Bashkimit Evropian si dhe prioritetet e mundshme të krimin. Gjithashtu, ajo synon të ndihmojë vendimmarrësit në **prioritarizimin e kërcënimeve të krimin të rëndë dhe të organizuar**, duke krijuar mundësinë e vlerësimit për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive sa më efikase.

Dokumenti ofron një analizë dhe vlerësim sistematik të plotë në lidhje me aktivitetet dhe rrjetet kriminale, të cilat ndikojnë në Bashkimin Evropian. Vlerësimi bazohet në një kombinim të njohurive operacionale, inteligjencës strategjike dhe të dhënave nga akademja, sektorët publikë dhe ata privatë. Përgatitja e dokumentit mbështetet në kontributin e dhënë falë bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet EUROPOL-it, autoriteteve ligjzbatuese të shteteve anëtare dhe palëve të treta, si agjencitë e BE-së, organizatat ndërkombëtare dhe vendet jo-anëtare të Unionit.



*Figura 2.* Metodologjia për Vlerësimin e Kërcënimit të Krimin të Organizuar (SOCTA) 2021 e Bashkimit Evropian

*Burimi:* EUROPOL (Metodologjia SOCTA)



## Hartimi i Strategjive Gjithëpërfshirëse kundër Krimin të Organizuar

Strategjitë kundër krimin të organizuar përbëjnë instrumente të rëndësishme për të adresuar fenomenin e krimin të organizuar, ndërkohë që gjithnjë e më shumë është evidentuar nevoja për një qasje shumëdimensionale, e cila të përfshijë aktorë të ndryshëm në hartimin dhe zbatimin e strategjisë.

Duke qenë një instrument i rëndësishëm në luftën kundër krimin të organizuar, përcaktimi i qartë i objektivave, aktiviteteve dhe mjeteve është parashikuar si një nga proceset më të rëndësishme për suksesin në zbatimin e strategjive.

Në këtë kontekst komponentët kryesorë për hartimin e një strategjie duhet të përfshijnë katër parime të përgjithshme të **parandalimit, goditjes, mbrotjes dhe promovimit**.<sup>25</sup> Bazuar mbi këto parime, duhet të kryhet edhe zhvillimi i objektivave që është edhe komponenti më i kritik i një strategjie.



*Figura 3.* Parimet/qasjet kryesore për ndërtimin e objektivave në strategjitë kundër krimin të organizuar

*Burimi:* Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC)

<sup>25</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), "Udhëzues i Strategjisë për Krimin e Organizuar për zhvillimin e strategjive me ndikim të lartë": [https://sherloc.unodc.org/cld/uploads/pdf/Strategies/Toolkit\\_-\\_Albanian.pdf](https://sherloc.unodc.org/cld/uploads/pdf/Strategies/Toolkit_-_Albanian.pdf)

Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të strategjisë përbën gjithashtu një proces thelbësor për të matur suksesin e zbatimit të strategjive kundër krimit të organizuar. Ky proces është thelbësor për të përcaktuar shkallën e arritur të suksesit, përfshirë arritjen e objektivave të ndryshëm.

Në vitin 2021 Bashkimi Evropian miratoi gjithashtu **Strategjinë për të luftuar krimin e organizuar 2021-2025**, e cila u miratua për t'iu përgjigjur rritjes së veprimtarisë dhe shtrirjes së krimit të organizuar, si dhe përmirësimit dhe përditësimit të qasjes së përbashkët në luftën kundër krimit të organizuar.<sup>26</sup> Strategjia synon të përqëndrojë veprime në tregjet kryesore kriminale dhe të adresojë korrupsionin dhe aspektet financiare të krimit të organizuar.

Pavarësisht nga qasjet e ndryshme që Bashkimi Evropian ka miratuar dhe zbatuar gjatë këtyre viteve në luftën kundër krimit të organizuar, mbetet i rëndësishëm të theksohet procesi mbi bazën e të cilit janë zbatuar këto qasje.

Kryerja e një vlerësimi të plotë mbi tendencat dhe prioritetet në fushën e krimit të organizuar përbën një nga hapat fillestar por më të rëndësishëm në funksion të ndërtimit të strategjive kundër krimit të organizuar të suksesshme dhe efektive.

Bazuar mbi këtë vlerësim, procesi i ndërtimit të objektivave, aktiviteteve dhe treguesve duhet të reflektojë parimet e përgjithshme të parandalimit, goditjes, mbrotjes dhe promovimit, në mënyrë që të bëhet e mundur monitorimi dhe matja e rezultateve konkrete në luftën ndaj këtij fenomeni.

---

<sup>26</sup> Komisioni i Bashkimit Evropian, “Strategjia e Bashkimit Evropian për të luftuar Krimin e Organizuar 2021-2025”: [https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/12735-Fighting-organised-crime-EU-strategy-for-2021-25\\_en](https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/12735-Fighting-organised-crime-EU-strategy-for-2021-25_en)

## IV. Qasja Strategjike e Shqipërisë në Luftën kundër Krimin të Organizuar

---

Shqipëria filloi të miratojë një qasje strategjike për të luftuar krimin e organizuar rreth 12 vjet më parë në vitin 2000, ku nëpërmjet miratimit të një sërë strategjish u synua të trajtoheshin forma të ndryshme të trafikimit, të përmirësoheshin sistemet e qeverisjes dhe të luftohej korrupsioni.<sup>27</sup>

Duhet theksuar fakti, që përveç miratimit të dokumentave strategjikë, gjatë periudhës së zbatimit të tyre u miratuan gjithashtu një sërë planesh veprimit dhe aktesh të tjera me qëllim forcimin e luftës kundër krimin të organizuar.

Strategjia e parë Ndërsektoriale për Luftën kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit (SNKKO 2008) u miratua në vitin 2008.<sup>28</sup> Ministria e Brendshme ishte institucioni i ngarkuar me detyrën e koordinimit të zbatimit të SNKKO 2008 përmes Sekretariatit Teknik, ndërkohë që të gjitha institucionet e përfshira duhet të raportojnë çdo tre muaj mbi zbatimin. Ministria e Brendshme orientohej në veprimtarinë e saj nga Grupi i Punës Ndërministror.

Në përgjigje të rekomandimeve të BE-së, Qeveria shqiptare miratoi në janar 2011 një plan veprimi që synonte adresimin e 12 prioritetëve kyç, përfshirë luftën kundër krimin të organizuar (Prioriteti 9).

Pas përfundimit të SNKKO 2008, qeveria shqiptare miratoi Strategjinë Ndërsektoriale për Luftën kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmin 2013-2020 dhe Planin e Veprimit për vitet 2013-2016 (SNKKO 2013).<sup>29</sup> SNKKO 2013 ishte vazhdim i SNKKO 2008, siç edhe parashikohej në kapitullin e parë për analizën e situatës.

Plani i Veprimit për periudhën 2013-2016 u miratua në të njëjtën kohë së bashku me SNKKO 2013. Pas përfundimit të Planit të Veprimit 2013-2016, nuk u miratua asnjë

---

<sup>27</sup> Strategjia Kombëtare Kundër Drogës 2006-2010;  
Strategjia Kombëtare Për Luftën Kundër Trafikut Të Fëmijëve 2008-2010;  
Strategjia Kombëtare Për Luftën Kundër Trafikut Të Qenieve Njerëzore 2008-2010;  
Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Luftës Kundër Korrupsionit për një Qeverisje Transparente 2008-2013;  
Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2007-2013;  
Strategjia e Rendit Publik 2007-2013

<sup>28</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1140, datë 30.7.2008 “Strategjia Ndërsektoriale për Luftën Kundër Krimin të Organizuar, Trafikimit edhe Terrorizmit 2008”

<sup>29</sup> Vendim Nr. 663, datë 17.7.2013. Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016

plan veprimi për një periudhë 2 vjeçare; ndërkohë që një vit përpara se të përfundonte SNKKO 2013-2020 qeveria miratoi Planin e Veprimit për periudhën 2019-2020.<sup>30</sup>

Gjatë periudhës së zbatimit të SNKKO 2013-2020 u miratuan dhe zbatuan gjithashtu një sërë masash të tjera në luftën kundër krimit të organizuar. Specifikisht, në vitin 2016 u miratua një plan veprimi për Ri/Integrimin Socio-Ekonomik të Grave dhe Vajzave Viktima të Trafikimit të Personave.<sup>31</sup>

Në përgjigje të rritjes së kultivimit të kanabisit në vitet 2015 dhe 2016, u miratua një Plan Veprimi në mars 2017.<sup>32</sup> Në nëntor 2017, Ministria e Brendshme filloi Operacionin 'Forca e Ligjit' dhe Task Forcën speciale kundër krimit të organizuar.<sup>33</sup> Ndërkohë që në vitin 2020 u miratua Akti Normativ 'Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike'.<sup>34</sup>

## Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025

Strategjia e re kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025 dhe plani i veprimit 2021-2022 (SKOKR) u miratua në fund të vitit 2020 dhe hyri në fuqi në janar të vitit 2021.<sup>35</sup> Strategjia e re parashikon **3 qëllime kryesore politike**, për arritjen e të cilave janë parashikuar **12 objektiva specifike** dhe **59 masa** për arritjen e objektivave specifike. Strategjia parashikon që këto prioritete, objektiva dhe masa do të zbatohen sipas një qasje e cila parashikon 1. **Goditjen** (pursue); 2. **Parandalimin** (prevention); 3. **Mbrojtjen** (protection).

---

<sup>30</sup> Vendim Nr. 616, datë 18.9.2019, Për miratimin e planit të veprimit për vitet 2019–2020, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqueve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013–2020

<sup>31</sup> Vendim Nr. 115, datë 17.2.2016 për një shtesë në Vendimin Nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqueve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020, dhe Planit të Veprimit për vitet 2013-2016"

<sup>32</sup> Vendim nr. 248, datë 29.3.2017 "Për miratimin e Planit të Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017–2020"

<sup>33</sup> Ministria e Brendshme. "Forca e Ligjit" – Krijohet Task Forca Speciale kundër krimit të organizuar.

<https://mb.gov.al/2017/11/07/forca-e-ligjit-krijohet-task-forca-speciale-kundër-krimit-të-organizuar-2/>

<sup>34</sup> Akt Normativ Nr. 1, datë 31.1.2020 "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike"

<sup>35</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1140, datë 24.12.2020 "Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe planin e veprimit 2021–2022": <https://mb.gov.al/plane-dhe-strategji/>



*Figura 4:* Qëllimet, Objektivat dhe Masat e parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025

*Burimi:* Ministria e Brendshme

Strategjia parashikon përfshirjen e 18 institucioneve, të cilat ngarkohen me përgjegjësi për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe Planit të Veprimit. Ndërsa Ministria e Brendshme mbetet institucioni përgjegjës që udhëheq hartimin, koordinimin dhe bashkërendimin e këtyre institucioneve të përfshira në këtë Strategji.

**Ministria e  
Brendshme  
(institucion  
koordinues)**

Ministria e Brendshme

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Mbrojtjes

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Kulturës

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Prokuroria e Përgjithshme

Shërbimi Informativ i Shtetit

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kombëtare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Banka e Shqipërisë

*Figura 5:* Institucionet e ngarkuara me përgjegjësi për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025

*Burimi:* Ministria e Brendshme

Monitorimi i Planit të Veprimit parashikohet të kryhet nga Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave (GMIP), ndërkohë që pjesëmarrës në këtë proces janë edhe përfaqësues nga institucionet kryesore përgjegjëse për çështjet e sigurisë, ku përfshihen Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale etj., donatorë dhe shoqëria civile (përfaqësues të organizatave joqeveritare).

Në lidhje me procesin e raportimit, institucionet e ngarkuara me përgjegjësi për zbatimin e strategjisë do të duhet të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe 1-vjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë, ndërkohë që Ministria e Brendshme është institucioni kryesues për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e raporteve 6-mujore dhe 1-vjeçare.

Institucionet ngarkohen gjithashtu të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, çdo 6-mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatën Teknik Ndërinstitucional.

Komiteti Drejtues Sektorial “Punët e brendshme”, drejtuar nga Ministri i Brendshëm, do të shqyrtojë, diskutojë dhe miratojë raportet e progresit, të monitorimit të arritjes së synimeve dhe prioriteteve në zbatim të këtij dokumenti strategjik dhe planit të veprimit.

Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të matet gjithashtu nëpërmjet dy mënyrave të vlerësimit: **(i) vlerësimi afatmesëm**, që do të kryhet në përfundim të dy vjeçarit, në fund të vitit 2022 dhe **(ii) vlerësimi përfundimtar**, pas përfundimit të periudhës së zbatimit (Figura 6).




Figura 6. Procesi i vlerësimit të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025

Burimi: Ministria e Brendshme



## Përputhshmëria me qasjen e Bashkimit Evropian

Pavarësisht kuadrit strategjik dhe akteve të ndryshme që Shqipëria ka miratuar dhe zbatuar në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, qasja e ndjekur në këtë drejtim paraqet disa mangësi thelbësore, të cilat kanë ndikuar në arritjen e rezultateve konkrete të vendit përkundrajt këtij fenomeni.

Një përpjekje për të vlerësuar **mangësitë e kuadrit strategjik** në luftën kundër krimit të organizuar, ishte Raporti “Vlerësim Bazë i Strategjisë Ndërsektoriale për Luftimin e Krimit të Organizuar, Trafikimit të Paligjshëm dhe Terrorizmit 2013-2020” i përgatitur në vitin 2020.<sup>36</sup>

Raporti paraqiti një vlerësim bazë për t’u përdorur nga institucionet e ngarkuara me zbatimin edhe shqyrtimin e strategjisë, me qëllim që të bënte të mundur vlerësimin, monitorimin dhe ngritjen e kapaciteteve. Ai synoi gjithashtu të ndihmonte në procesin e hartimit të strategjisë së re kundër krimit të organizuar, po aq sa për të informuar publikun lidhur me zbatimin edhe rezultatet e arritura deri tani në këtë fushë.

Si një vlerësim i jashtëm, raporti ofroi një perspektivë tjetër analitike lidhur me arritjet apo dështimet në përmbushjen e qëllimeve, objektivave edhe synimeve të parashikuara në dokument, duke ndihmuar kështu edhe në analizimin e faktorëve që kanë kontribuar në arritjet edhe/ose dështimet në zbatimin e strategjisë.

Një nga mangësitë serioze që evidentohet në qasjen e Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar lidhet me **mungesën e kryerjes së një vlerësimi të plotë, gjithëpërfshirës dhe sipas një metodologjie të mirëpërcaktuar** të ngjashme me atë të SOCTA. Mungesa e një vlerësimi të tillë ka krijuar boshllëqe në përcaktimin dhe identifikimin e kërcënimeve kryesore të Shqipërisë dhe për pasojë ka ndikuar edhe në formulimin defektoz të strategjive në luftën kundër krimit të organizuar.

Ky boshllëk është reflektuar në **mospërputhjen** ndërmjet kontekstit të krimit të organizuar dhe synimeve, objektivave, rezultateve të pritshme, impaktit si dhe mospërputhjeve logjike të rezultateve të përcaktuara në strategji: objektiva–aktivitete–tregues/indikatore, të cilat e bëjnë vështirësisht të matshëm rezultatet dhe ndikimin.

Këto mangësi janë evidentuar edhe në Strategjinë e re kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025. Përcaktimi i objektivave dhe

---

<sup>36</sup> Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Raport Vlerësimi “Strategjia Ndërsektoriale për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013-2020”, Link-u i publikimit: <http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2020/12/Raport-vleresimi-Krimi-i-organizuar.pdf>

masave/aktiviteteve të parashikuara nuk ndjek Ciklin e plotë të Zinxhirit të Rezultateve, ku përfshihet edhe përcaktimi i *input-eve*, *output-eve*, *outcome* dhe *impaktit* përkatës në funksion të përmbushjes së objektivave.

Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e masave/aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 për secilin nga 12 objektivat specifike janë ndërtuar në formën e output-it ose outcome dhe nuk mund të zbatohen si të tilla.

Mungesa e këtyre elementëve e bën të paqartë dhe konfuz monitorimin dhe vlerësimin e përmbushjes së objektivave të parashikuar dhe të vetë qëllimeve strategjike (Qëllimeve të Politikës), pasi për çdo masë/aktivitet të parashikuar duhet të korrespondojnë outpute të caktuara, të cilat rezultojnë nga masat/aktivitetet dhe outcome, të cilat shërbejnë për të vlerësuar nivelin e përmbushjes së rezultateve të synuara.

Gjithashtu, **mungesa e publikimit të treguese/indikatoreve** në Planin e Veprimit 2021-2022 evidenton një tjetër mangësi në formulimin e strategjisë. Për të matur dhe vlerësuar nivelin e zbatimit dhe arritjeve për secilin nga masat/aktivitetet, output dhe outcome është e rëndësishme të përcakton indikatorë që lidhen me indikatorë të masave/aktiviteteve, indikatorë të outputeve dhe indikatorë të outcome. Në këtë mënyrë është e pamundur të bëhet një vlerësim i procesit, outputeve dhe impaktit.

**Treguesit e performancës** përbëjnë një nga elementët më kryesorë në drejtim të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë si edhe vetë zbatimit të ligjit kundër krimin të organizuar. Në këtë kontekst, mungesa e këtyre treguesve përbën një nga mangësitë serioze të Strategjisë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025.

Ashtu siç është evidentuar edhe në raportin e lartpërmendur, **mungesa e raporteve të rregullta** të monitorimit dhe komunikimit lidhur me proceset e zbatimit të strategjisë është një nga problematikat më të theksuara, e cila ka ndikuar në cënimin e qëllimit për të cilat këto dokumente miratohen.

Në rastin e SNKKO 2013-2020 gjatë tetë viteve nuk pati asnjë debat publik në Kuvend të mbështetur mbi raporte të zbatimit të Strategjisë edhe pse krimi i organizuar ka qënë temë mbizotëruese në retorikën dhe diskursin politik. Kjo solli që strategjia, zbatimi i saj dhe të dhënat/përfundimet të mos ndikonin në hartimin e masave apo politikave kundër krimin të organizuar në vitet 2013 – 2020.

Një tjetër problematikë lidhet me **llogaridhënien publike** dhe **vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit** të strategjisë. Strategjia e re kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025 nuk parashikon publikimin e Raporteve të

monitorimit dhe zbatimit, çka e bën të pamundur përfshirjen e palëve të interesuara të shoqërisë dhe vlerësimin e pavarur të realizimit të objektivave dhe strategjisë në tërësi. Ky vlerësim është i rëndësishëm edhe përkundrejt fodeve të dedikuara për zbatimin e strategjisë, për të cilën janë parashikuar rreth 164 milion euro për një periudhë 5 vjeçare (33 milion euro në vit).

Edhe në lidhje me adresimin e qasjeve të tjera në luftën kundër krimit të organizuar, siç është ajo parandaluese, evidentohen mangësi. Megjithëse ligje të ndryshme në Shqipëri përfshijnë masa administrative, si për të parandaluar aksesin e krimit të organizuar në ekonomi ashtu edhe për t'a goditur atë ekonomikisht, këto masa nuk burojnë nga një qasje e qartë apo politike e mirëmenduar për përdorimin e masave administrative.<sup>37</sup>

Nga ana tjetër, mungesa e një politike ka ndikuar tek mënyra se si është hartuar korniza legjislative. Mund të thuhet se **mungojnë sistemet dhe kapacitetet për mbledhjen, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave**, si dhe për vënien në dispozicion të agjencive dhe koordinimin ndërmjet tyre në zbatim.<sup>38</sup>

---

<sup>37</sup> Arjan Dyrmishi, Mandrit Kamolli, “The administrative approach in fight organized crime: Exploring the possibility of implementation in Albania”: <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2018/11/The-administrative-approach-in-fighting-organized-crime-in-Albania.pdf>

<sup>38</sup> Po aty.

# Konkluzione

---

Ndërkohë që volumi i krimit të organizuar është rritur, aplikimi i qasjeve efektive në luftën ndaj këtij fenomeni përbën një faktor kyç dhe të rëndësishëm në arritjen e rezultateve konkrete.

Megjithë hartimin dhe zbatimin e kuadrit strategjik për të luftuar krimin e organizuar që Shqipëria ka ndërmarrë veçanërisht pas viteve 2000, ende mungon një qasje e mirëpërcaktuar në adresimin e këtij fenomeni.

Kjo ka ardhur edhe si rezultat i mangësive të identifikuara për të kryer vlerësime sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në një metodologji të mirëpërcaktuar, në mënyrë që të bëhet e mundur dhe të reflektohen objektiva dhe tregues konkretë në përputhje me parimet e përcaktuara.

Nga ana tjetër, për të luftuar në mënyrë efektive krimin e organizuar nuk mjafton vetëm shkatërrimi i grupeve të krimit të organizuar dhe/ose konfiskimi i pasurive të tyre, pasi gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre kriminale dëmi ndaj interesit publik dhe individëve të caktuar tashmë është bërë.

Në këtë kontekst, monitorimi dhe shkatërrimi i grupeve të krimit të organizuar mbetet i rëndësishëm, por në mënyrë të veçantë rëndësi ka parandalimi i veprimtarive kriminale për të depërtuar në sferat ekonomike, sociale dhe politike të vendit.

Ky faktor mbetet i rëndësishëm po të kihen parasysh rezultatet në kuadër të dy Strategjive Kundër Krimit të Organizuar të 2008-2013 dhe 2013-2020, të cilat përqendroheshin tek qasja goditëse e krimit të organizuar duke sjellë në këtë mënyrë një rritje të tij ndër vite.

Nisur nga kjo, qasja parandaluese duhet të kombinohet në shumë forma duke filluar nga edukimi dhe ndërgjegjësimi mbi kërcënimet që vijnë nga krimi i organizuar për të rritur rezistencën shoqërore dhe atë të biznesit, deri tek përfshirja e administratës publike në parandalimin e qasjes së krimit të organizuar në ekonominë e ligjshme (qasja administrative), përfshirë konfiskimin administrativ që kohët e fundit është përdorur më shpesh.

# Rekomandime

---

Zhvillimet dhe tendencat në strukturimin, organizimin dhe rrjetëzimin e grupeve të krimit të organizuar kërkojnë një përmirësim të të kuptuarit të këtyre tendencave dhe për këtë arsye edhe kapacitete dhe mjete të përmirësuara për të monitoruar këto tendenca.

Në këtë kontekst, është e nevojshme që të mblidhen në mënyrë të standardizuar **të dhëna dhe statistika** mbi burimet financiare dhe burimet e tjera të rëndësishme të cilat ndikojnë në vendimet e politikave dhe masa të tjera, si dhe të publikohen në funksion të rritjes së transparencës dhe përdorimit për qëllime të ndryshme. Gjithashtu **zhvillimi i metodave** për mbledhjen sistematike të analizave dhe përdorimin e të dhënave ndihmon për të kuptuar më mirë volumin e krimit të organizuar.

Përveç njohurive mbi grupet dhe veprimtaritë kriminale, marrja e njohurive mbi **vlerën e përgjithshme të tregut të krimit të organizuar dhe nivelin e infiltrimit në biznese të ligjshme** nga grupet e krimit të organizuar është çelësi për të matur efektivitetin e luftës kundër krimit të organizuar.

Zhvillimi dhe **forcimi i aftësive** për të mbledhur të dhëna mbi vëllimet e fitimeve të krijuara nga aktivitete të ndryshme të krimit të organizuar ndikon në rritjen e njohurive të zbatimit të ligjit.

Meqenëse grupet e krimit të organizuar veprojnë në nivel transnacional, si në zonat shqiptare ashtu edhe në ato të BE-së, ato duhet të hetohen si **subjekte të pandashme**.

Veprimi efektiv kundër veprimtarive të krimit të organizuar kërkon një **kombinim të qasjeve** të parandalimit dhe mbrojtjes, shtypjes dhe rritjes së vetëdijes.

Meqenëse përdorimi i dhunës mbetet një *modus operandi* kryesor i grupeve të krimit të organizuar, fokusi duhet të rritet drejt **identifikimit dhe sigurimit të mbrojtjes për viktimat** e krimit të organizuar.

Forcimi i kuadrit për të zvogëluar ndikimin e krimit të organizuar në proceset politike dhe përmirësimi i cilësisë së vlerësimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë, duhet të kryhet në mënyrë sistematike.

**Kryerja, publikimi dhe diskutimi periodik** mbi vlerësimin e kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe përcaktimin sipas metodologjisë SOCTA të BE-së duhet të shndërrohet në një praktikë të vazhdueshëm. Është e nevojshme që për hartimin e kësaj analize sipas metodologjisë SOCTA të **forcohen kapacitetet e brendshme të**

**institucioneve respektive shqiptare**, nëpërmjet trajnimeve specifike të dedikuara për punonjësit përgjegjës, duke siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë e punës së tyre dhe rritjen e profesionalizimit.

Në lidhje me hartimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike, duhen ndërtuar **kapacitete** për të kryer vlerësimin, i cili duhet të jetë **multidisiplinor dhe gjithëpërfshirës**. Gjithashtu duhet ndërtuar një **kornizë për diskutim dhe konsultim publik të informuar** duke përfshirë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme aktorë shoqërorë dhe palë të interesuara duke përmirësuar debatin publik përmes pjesëmarrjes.

Duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe koherente **kuadri i rezultateve** në përputhje me parimet e *Parandalimit, Goditjes, Mbrojtjes dhe Promovimit*, në mënyrë që të bëhet e mundur matja e saktë e rezultateve të strategjisë dhe arritja e objektivave të parashikuara.

**Publikimi i raporteve** të monitorimit të strategjisë është i rëndësishëm për të siguruar **transparencë dhe llogaridhënie** në procesin e vlerësimit të rezultateve dhe arritjes së objektivave të parashikuara.

Duhet të ketë një fokus konkret në parandalimin e krimit të organizuar në përputhje me qasjen administrative kundër krimit të organizuar të BE.

# Referenca

---

- Akt Normativ Nr. 1, datë 31.1.2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”
- *Anti-money laundering and counter-terrorist financing measures*, Albania, Fifth Round Mutual Evaluation Report. Moneyval (2018)7: <https://rm.coe.int/committee-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/16808ff138>
- *Draft Konkluzionet e Këshillit mbi qasjen administrative për të parandaluar dhe luftuar krimin e rëndë dhe të organizuar*, Këshilli i Bashkimit Evropian, 9061/16: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-9061-2016-INIT/en/pdf>
- *Draft Konkluzionet e Këshillit për krijimin dhe zbatimin e një cikli politikash të BE-së për krimin e organizuar dhe krimet e rënda ndërkombëtare*, Këshilli i Bashkimit Evropian, 15358/10: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-15358-2010-INIT/en/pdf>
- Dyrmishi. A., Kamolli. M., “*The administrative approach in fighting organized crime: Exploring the possibility of implementation in Albania*”: <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2018/11/The-administrative-approach-in-fighting-organized-crime-in-Albania.pdf>
- “*Forca e Ligjit*”, Ministria e Brendshme – Krijohet Task Forca Speciale kundër krimit të organizuar: <https://mb.gov.al/2017/11/07/forca-e-ligjit-krijohet-task-forca-speciale-kundër-krimit-të-organizuar-2/>
- *Indeksi Global për Krimin e Organizuar 2021*, Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar: <https://ocindex.net/country/albania>
- *Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit*, Ministria e Brendshme, 2018: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/PROCEDURAT-STANDARDE-T%C3%8B-VEPRIMIT-PER-MBROJTJEN-E-VIKTIMAVE-TE-TRAFIKIMIT.pdf>
- Raport Publik 2019, Shërbimi Informativ i Shtetit: <https://www.shish.gov.al/files/Raporti%20publik.pdf>
- Raport Vlerësimi “*Strategjia Ndërsektorale për Luftën kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013-2020*”, Qendra për Studimin e

Demokracisë dhe Qeverisjes: <http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2020/12/Raport-vleresimi-Krimi-i-organizuar.pdf>

- Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/negotiations-status/albania\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/negotiations-status/albania_en)
- *Raporti Botëror i Drogave 2021*, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC): <https://www.unodc.org/unodc/en/data-and-analysis/wdr2021.html>
- *Raportet për Trafikimin e Personave*, Departamenti i Shtetit të SHBA: <https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/>
- *Udhëzues i Strategjisë për Krimin e Organizuar për zhvillimin e strategjive me ndikim të lartë*, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC): [https://sherloc.unodc.org/cld/uploads/pdf/Strategies/Toolkit\\_-\\_Albanian.pdf](https://sherloc.unodc.org/cld/uploads/pdf/Strategies/Toolkit_-_Albanian.pdf)
- *Strategjia e Bashkimit Evropian për të luftuar Krimin e Organizuar 2021-2025*, Komisioni i Bashkimit Evropian: [https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/12735-Fighting-organised-crime-EU-strategy-for-2021-25\\_en](https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/12735-Fighting-organised-crime-EU-strategy-for-2021-25_en)
- *Vlerësim i Kërcënimit të Krimin të Rënda dhe të Organizuar të Bashkimit Evropian (EU SOCTA 2021)*, EUROPOL: [https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/socta2021\\_1.pdf](https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/socta2021_1.pdf)
- *Vlerësimet Kombëtare Strategjike të Krimin të Rëndë dhe Organizuar*, Agjencia Kombëtare e Krimin në Britani (NCA): [https://www.nationalcrimeagency.gov.uk/who-we-are/publications?limit=100&sort=created\\_on&search=national%20strategic%20assessment&direction=desc](https://www.nationalcrimeagency.gov.uk/who-we-are/publications?limit=100&sort=created_on&search=national%20strategic%20assessment&direction=desc)
- Zhilla. F., Lamallari. B., *“Evoluimi i strukturave të organizuara kriminale në Shqipëri”*, OSFA 2016: [http://www.osfa.al/sites/default/files/evolution\\_of\\_the\\_albanian\\_organized\\_crime\\_groups.pdf](http://www.osfa.al/sites/default/files/evolution_of_the_albanian_organized_crime_groups.pdf)
- *Zonat problematike të krimin të organizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor: Identifikimi dhe analizimi i pikave të dobëta në zona të caktuara në një kontekst rajonal*, Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, Maj 2019: <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-Albanian-13Jun1110-Web.pdf>



## Ligje

- Ligji Nr. 9642 datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”
- Ligji Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”
- Ligji Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 12/2018 datë 5.3.2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”

## Strategji & Plane veprimi

- Strategjia Kombëtare Kundër Drogës 2006-2010
- Strategjia e Rendit Publik 2007-2013
- Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2007-2013
- Strategjia Ndërsektoriale për Luftën Kundër Krimit të Organizuar, Trafikimit edhe Terrorizmit 2008
- Strategjia Kombëtare Për Luftën Kundër Trafikut Të Fëmijëve 2008-2010
- Strategjia Kombëtare Për Luftën Kundër Trafikut Të Qenieve Njerëzore 2008-2010
- Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Luftën Kundër Korrupsionit për një Qeverisje Transparente 2008-2013
- Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqueve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016
- Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe planin e veprimit 2021–2022
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 115, datë 17.2.2016 për një shtesë në Vendimin Nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqueve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020, dhe Planit të Veprimit për vitet 2013-2016”
- Plani i veprimit për vitet 2019–2020, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqueve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013–2020
- Plani i Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017–2020

